

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh. [REDACTED] Sh. [REDACTED] nga [REDACTED] dhe P. [REDACTED] S. [REDACTED] nga [REDACTED] – [REDACTED], per shkak te vepres penale lejimi i lidhjes se paautorizuar ne sherbime nga neni 322 par.1 te KP-es, dhe vepra penale lidhje e paautorizuar ne sherbime nga neni 321 te KP-es, sipas aktakuzes së Prokurorise Themelore në Prizren PP.nr. [REDACTED] 2016 të datës 10.01.2017, pas mbajtjes së seancës fillestare, në prezencën e Prokurorit Themelore në Prizren Zejnulla Gashi, të akuzuareve, me datë 24.11.2017, morri dhe shpalli publikisht këtë:

AKTGJYKIM

1.I akuzuari Sh. [REDACTED] Sh. [REDACTED] nga i ati G. [REDACTED] dhe e ëma Z. [REDACTED] e vajzërisë P. [REDACTED] i lindur më datë [REDACTED] në [REDACTED], ku edhe jeton ne rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] vite te shkolles fillore te kryer, furtar, i martuar baba i 2 femijeve, i gjendjes se dobet ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. I akuzuari P. [REDACTED] S. [REDACTED] nga i ati Z. [REDACTED] dhe e ema Z. [REDACTED] e vajzërisë B. [REDACTED] i lindur me [REDACTED] ne [REDACTED] tani me banim ne [REDACTED] ne rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] ka te kryer shkollen fillore, elektrikist, i pamartuar, i gjendjes se dobet ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosoves.

JANË FAJTOR


I akuzuari Sh. [REDACTED] Sh. [REDACTED]

I.Se me dt. 24.06.2016 rreth ores 19,30 min, ne Prizren, ne rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] pikerisht ne shtepin e tije, lejon qe lidhja ose rilidhja e paautorizuar ne perçues te sherbimit ose ne rrjet te shperndarjes qe gjendet ne pronen e cila eshte ne posedim, pronesi apo kontroll te tije, dhe mundeson lidhjen apo rilidhjen e paautorizuar ne perçues te sherbimit komunal ose ne rrjet te shperndarjes ne pronen e cila eshte ne posedim, pronesi apo kontroll te tije, ne ate menyre qe e ka ftuar te pandehurin P. [REDACTED] S. [REDACTED] qe te rikyqet ne rrjetin elektrik, pas çkyqjes per shkak te borgjit nga zyrtaret e Keds-it ne Prizren,

-kesodore ka kryer vepren penale lejimi i lidhjes se paautorizuar ne sherbime nga neni 322 par.1 te KP-es.

I akuzuari Petrit Sahitaj,

II.Se me date, kohe dhe vend te njejte, si ne dispozitivin nen 1 te kesaj aktakuze, i pandehuri lidhet apo rilidhet ne perçuesin e rymes elektrike apo ne rrjetin per perçim, apo shperndarje te çfaredo sherbimi komunal, ne efardo menyre, drejtperdrejt apo terthorazi, pa autorizim te furnizuesit te autorizuar, ne ate menyre qe ka lidhur energjin elektrike ne menyre direkte ne shtyllë, me ç' rast ndeshmarrjes se demtuar Keds – distrikti ne Prizren, i ka shkaktuar dem material,



-kesodore ka kryer vepron penale lidhje e paautorizuar ne sherbime nga neni 321 te KP-es.

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 42, 43, par.1 pika 1.3, 46, 49 par.1 p.1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75 e 76, te KPK-se, dhe neni 365 te KPPK-es te akuzuarve iu shqipton:

Te akuzuarit **Sh. [REDACTED] Sh. [REDACTED]** i shqiptohet,

DENIM ME GJOBE

Ne lartesi prej **300 Euro** si ne dispozitivin nen 1 te kesaj aktakuze, te cilen shume te denimit eshte i obliguar qe te paguaj ne afat prej 15 diteve, pas plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi, nese denimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim i njeiti do te zevendesohet me denim burgimi duke llogaritur per çdo 20 euro nje dite burg, respektivisht 15 dite burgim, dhe

DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i verteton denimin me burgim ne kohëzgjatje prej 3 muajve i cili denim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 viti, nga dita e plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi, nese i akuzuari nuk do te kryej veper te re penale.

Te akuzuarit **P. [REDACTED] S. [REDACTED]** i shqiptohet,

DENIM ME GJOBE

Ne lartesi prej **150 Euro** si ne dispozitivin nen 2 te kesaj aktakuze, te cilen shume te denimit eshte i obliguar qe te paguaj ne afat prej 15 diteve, pas plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi, nese denimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim i njeiti do te zevendesohet me denim burgimi duke llogaritur per çdo 20 euro nje dite burg, respektivisht 7 dite burgim, dhe

DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i verteton denimin me burgim ne kohëzgjatje prej 3 muajve i cili denim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 viti, nga dita e plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi, nese i akuzuari nuk do te kryej veper te re penale.

Te akuzuarit obligohen që ti paguajne shpenzimet e procedurës penale sipas llogarise se gjykates, ne emer te të paushallit gjygjësor secili veç e veç shumen me nga **30 Euro**, të gjitha këto ne afat prej 15 ditësh, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nen kercnim te ekzekutimit te dhunshem.

Perfaqesuesi i te demtuares Keds – distriktit ne Prizren, per realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet ne kontest te rregullte civilno-juridik.

A r s y



Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me PP.nr. 2698/2016 te dt. 10.01.2017, kunder te akuzuarve Sh. [redacted] Sh. [redacted] nga [redacted] dhe P. [redacted] S. [redacted] nga [redacted] - [redacted] per shkak te veprave penale lejimi i lidhjes se paautorizuar ne sherbime nga neni 322 par.1 te KP-es, dhe vepra penale lidhje e paautorizuar ne sherbime nga neni 321 te KP-es,

Gjykata ne shqyrtim fillestar ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarve te cilet vullnetarisht e kane pranuar fajesin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se te akuzuarit kane kuptuar natyren dhe pasojat e pranimet te fajit per veprat penale te cilat iu vihen ne bare, e qe pranimi i fajit eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat te akuzuarit kane qene te njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarve eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuarve formohen te gjitha elementet e veprave penale lejimi i lidhjes se paautorizuar ne sherbime nga neni 322 par.1 te KP-es, dhe vepra penale lidhje e paautorizuar ne sherbime nga neni 321 te KP-es, per kete gjykata te akuzuarit i shpalli fajtores dhe iu shqiptoi denimet me gjobe dhe me kusht si te merituar, paraprakisht duke e vertetuar pergjegjesine e tyre penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarve gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KPPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarve, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tyre, ne kuptim te nenit 74, 75, e 76 gjykata morri per baze edhe faktin se te akuzuarit kane bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i tyre ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, kane pranuar fajesin si dhe kane shprehur keqardhje per shkak te veprave penale te kryera, duke pasur parasysh edhe gjendjen e dobet ekonomike te te akuzuarve, te pa pune, mbajtes te familjeve te tyre, kane pasur sjellje korrekte para gjykates, deri me tani te pa gjykuar, çka nenkupton se nuk kane ardhur ndesh me rregullat pozitive, andaj gjykata iu shqiptoi denimet me gjobe dhe me kusht, sepse konsideron se me kete mase sanksionuese do te arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesis se tyre dhe te te njejtë do te ndikoj qe ne te ardhmen te jene me te kujdesshem dhe te permbahen nga veprimet e tilla inkriminuese.


Vendimi mbi paushallin gjyqesor gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 450, e 451 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN

P.nr. 45/2017 të datës 24.11.2017

Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari



Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

UDHËZIM JURIDIK: Kunder ketij aktgjykimi i shqiptuar ne Prizren, te akuzuarit e pakenaqur ka te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate